



Republika e Kosovës Komuna e Malishevës



DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVA-SKUPSTINA OPSTINE MALISHEVO



Adresa: Malishevë
Rr."Skënderbeu" p.n
Email: dkaemalisheva@gmail.com
Tel:029-269-003

Nr. i protokollit: 11/_____
Datë: ____/____/____

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 30/07/2025
PRIMLJENO:
Nr.No.Br: 11/830

Drejtoria komunale e Arsimit në Malishevë duke u bazuar në Ligjin Nr. 08 L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, UA-MFPT, Nr.01/2024 Për Rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.01/2022 për ndryshim dhe plotësim të UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.05/2015 Për Normativin për Mësimdhënsit e Arsimit Profesional, Rregullores, UA-MASHT, nr.05/2022 RREGULLORE (QRK) Nr:19/2024 PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE, MËSIMDHËNËSVE, BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL, ASISTENTËVE, INSTRUKTORËVE DHE SEKRETARËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE AFTËSUESE (IEAA) TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, UDHËZUESIT PËR DKA-TË PËR ZBATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES, SË MËSIMDHËNËSVE. Drejtorai për Arsim, dhe Edukim, Shpallë këtë:

KONKURS PËR KËTO VENDE TË LIRA TË PUNËS

Nr.	Niveli	Institucioni shkolla	Vendi	Pozita vendi i lirë	orët	Vendi i lire zavendesim	Koeficienti i pagës
1.	SHML	SHML " Lasgush Poradeci " në Kijevë	Kijevë	Hoteleri-Turizem	13	Me kohë të caktuar	6.8

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- 1) Formulari i aplikimit (kërkesa) i cila merret në komunë në zyrën pritëse numër 12 dhe e plotson kandidati
- 2) Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- 3) Rezumeja personale (CV),
- 4) Çertifikata e lindjes,
- 5) Diplomat e fakultetit të kryer në nivelin përkatës (ose certifikatat të diplomimit të noterizuara jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- 6) Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/ saj shëndetësore;
- 7) Vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 8) Licencën e mësimdhënsit /es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënsit;

- 9) Përgjithshëm për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimitdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet përmbushja e kriterit të parshikuar në pikën 6.
- 10) Dëshmi se nuk është i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- 11) Kandidatët që a kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portofolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

Vlerësimi i kandidatëve:

2. Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:

- a) Testit me shkrim, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- b) Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm.

Informata të përgjithshme :

Aplikacionet merren dhe dërgohen në Zyrën Pritëse në Komunën e Malishevës. Dokumentet e kompletuar dorëzohen të fotokupjuar, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngusht do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur nga data 30.07.2025 deri më, 29.08.2025.

Konkursi publikohet në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe dhe SIMBNJ

Shtojca 1. Udhëzime për përgatitjen e Portfolios profesionale

Portfolio Profesionale shërben si instrument për paraqitjen e përvojës dhe aftësive profesionale të fituara

dhe zhvilluara nga shkollimi paraprak apo përvoja profesionale. Përvoja profesionale përfshinë përvojën

si mësimitdhënës në institucione shkollore duke përfshirë dëshminë e aktiviteteve të zhvillimit profesional.

Ndër të tjera, Portfolio profesionale mund të përfshijë:

- Biografinë.
- Licencën e mësimitdhënësit (mësimitdhënësit që kanë licencë) dhe certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve. Në portfolio vendosen mak.3 certifikata të trajnimit, të fituara në programet e trajnimit nga fusha e mësimitdhënies dhe të nxënës.
- Letër motivuese ose një ese personale të lidhur me mësimitdhënien. Ky dokument reflekton parimet dhe vlerat që ka kandidati për mësimitdhënien moderne dhe synimet për zhvillim në kontekst të zhvillimeve në sistemin e arsimit në Kosovë.
- Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (mund të jenë letër referencë apo certifikatë për pjesëmarrje në grupet punuese për zhvillimin e kurrikulave, udhëheqje të programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrje dhe kontribut në konferenca) etj.
- Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimitdhënie (shembuj të planeve të mësimit, shembuj të projekteve, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).

Shefi i DKA-se Sabit Berisha